

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 18317 Prot.
Datë 21.10.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1436 Prot

Tiranë, më 20.10.2022

Nr. 1413 Dosje

VENDIM

PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 716 (2333), të lëshuar më datë 10.04.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1413, Datë 10.10.2019 kërkesën e kreditorit Inspektoriatit Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujërave dhe Turizmit I.SH.M.P.U.T (sot – Agjencia Kombëtare e Mjedisit), ndaj debitorit Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k., në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr. 6, datë 09.11.2018.

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 1879 Prot, date 10.10.2019 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k., dhe Z. Korado Teodori (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k.).

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar nga Përmbaruesi Gjyqësor Altin Vako pranë:

- DRSHTRR Tiranë me shkresën Nr. 2014 Prot, datë 29.10.2019
- Qendrës Kombëtare të Biznesit me shkresën Nr. 2013 Prot, datë 29.10.2019
- Bankave Nivelit II me shkresat Nr. 2015 Prot, datë 29.10.2019, Nr. 305 Prot, datë 24.02.2020 dhe Nr. 1560 Prot, datë 20.10.2021

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ

Se në datë 20.10.2022, pas nxjerrjes së llogarisë pranë “Banka Kombëtare Tregtare” Sh.a, rezultoi se debitori Shoqëria “TEODORI” Sh.p.k, kishte paguar edhe shumën e mbetur të detyrimit, duke zbatuar vendimin e gjykatës.



Person Fizik “ALTIN VAKO”, Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit të Ligjit Nr. 26/2019, datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,


VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 716 (2333), datë 10.04.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. DRSHTRR Tiranë, të bëjë ç’bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Shoqëria “TEODORI” Sh.p.k me Nr. NIPT-i: K81713014H dhe Z. Korado Teodori (atësia: Faik, i datëlindjes: 08.05.1987) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 2014 Prot, datë 29.10.2019 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit II të bëjnë ç’bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k me Nr. NIPT-i: K81713014H dhe Z. Korado Teodori (atësia: Faik, i datëlindjes: 08.05.1987) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k, të bllokuara me anë të shkresave Nr. 2015 Prot, datë 29.10.2019, Nr. 305 Prot, datë 24.02.2020 dhe Nr. 1560 Prot, datë 20.10.2021 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Biznesit të bëjë ç’bllokimin e aksioneve apo kredive të Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k me Nr. NIPT-i: K81713014H dhe Z. Korado Teodori (atësia: Faik, i datëlindjes: 08.05.1987) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “TEODORI” Sh.p.k, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 2013 Prot, datë 29.10.2019 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO



The image shows a handwritten signature in blue ink that overlaps a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'ALTIN V. VAKO' in the center, and 'PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT' at the bottom. The signature is written in a cursive style.



Person Fizik “ALTIN VAKO”, Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39